



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur, në vazhdimin e seancës së 50-të, të mbajtur më datë 23.07.2021 morri

VENDIM

Denoncimi i dorëzuar nga parashtrues i panjohur ----- nga----- në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në bazë të të cilit është formuar lënda me numër 12-103/1 të datës 09.01.2020, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, pasi shqyrtimit të përmbajtjes së lëndës, përcaktoi se nuk ka elemente për veprim kompetent mbi të njëjtën.

Lënda me numër 12 -103/1 të datës 09.01.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-103/1 të datës 09.01.2020 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi i njohur-----nga-----.

Në denoncim, parashtruesi pohon se është një pedagog i papunë i cili ka kaluar provimin profesional për bashkëpunëtor profesional-pedagog dhe kërkon të kontrollojë punësimin e bashkëpunëtorit profesional-pedagog në SHFK ----- . Parashtruesi pohon se në Agjencinë e Punësimit ishte ose është akoma i vetmi punëkërkues aktiv pedagog në Komunë -----, dhe në shkollë duke marrë përsipër ata tashmë janë të punësuar për shumë vite në një shkollë tjetër dhe nga një komunë tjetër, me disa vite të mbetura deri në pension. Për shkak të kësaj, ai humbi punën si pedagog i ri dhe mbeti i papunë, dhe punonjësi punësohet përsëri. Parashtruesi pohon se shkolla ishte pa pedagog nga shtatori deri në disa ditë para se të dorëzohet denoncimi, dhe ai nuk u kontaktua nga Agjencia e Punësimit. Parashtruesi

gjithashtu kërkon të verifikojë nëse punësimi ishte partiak dhe shprehu pakënaqësinë me faktin se të rinjve nuk u jepet një shans për të filluar punën dhe për të realizuar veten profesionalisht.

Pas shqyrtimit dhe studimit të pohimeve nga denoncimi, KSHPK -ja arriti në përfundimin se e njëjta përmban pohime dhe shprehen pakënaqësi personale të parashtruesit, dhe nuk tregon paligjshmëri specifike në procedurën për punësim që mund të tregojnë veprime korruptive. Prandaj, në seancë, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vlerësoi se nuk ka elementë për veprimin e tij kompetent sipas lëndës në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Duke mar parasysh të theksuaren më sypër, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit (Gayeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.12/19), vendosi si në dispozitat e këtij vendimi.

Përgaditi; M.r B.K.SH, Këshilltar
Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
KRYETARI
Biljana Ivanovska

